

TRYEZË DISKUTIMI

Programi i Integruar i Zhvillimit Rural dhe qasja sinergjike ndërmjet aktorëve

Hotel Tirana International (Salla Abret)
28 Shkurt 2018, Ora 14:00 – 16.00

Programi i Integruar i Zhvillimit Rural (PIZHR), i njohur ndryshe si programi i “100 fshatrave”, shënon një kthesë në politikat qeveritare dhe instrumentat e deritanishëm që janë ndërmarrë në sektorin e zhvillimit rural, të cilat më së shumti kanë qenë të orientuara kryesisht nga bujqësia nëpërmjet masave tipike bujqësore. Duke qenë se kjo politikë krijon një mjedis inkurajues për aktorët publikë dhe jo-publikë në nivel vendor për zbatimin e qasjes LEADER, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) organizon këtë tryezë për të nxitur sinergji në nivel politikash, si dhe për të rritur impaktin e këtij programi për një zhvillim të qëndrueshëm.

Të ftuarit e këtij takimi janë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, agjencive kryesore publike, anëtarë të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Parlamentit, donatorë dhe agjenci ndërkombëtare, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, akademia, si dhe të tjerë aktorë të interesuar.

Organizatorët do të ndajnë me pjesëmarrësit një Komentari të shkurtër mbi racionalen dhe objektivat e kësaj tryeze në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm. Aktiviteti ndërton njëkohësisht mbi rekomandimet e Deklaratës së Parlamentit të Parë Rural Shqiptar, mbajtur më 28-30 Shtator 2017.

PROGRAMI	
14:00	Fjala përshëndetëse Sotirag Hroni, Kryetar Bordi ANRD Illir Halilaj, Zëvendës Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Romina Kuko, Zëvendës Ministër i Brendshëm
14:15	<i>Vështrim i përgjithshëm i programit “100 fshatrat”</i> - Enea Hoti, Këshilltar i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural <i>Prezantim i shkurtër i Komentarit “Qasja LEADER dhe programi i ‘100 fshatrave’</i> - Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare, ANRD
14.45	Panel diskutimi Anëtar i Parlamentit Shqiptar Përfaqësues i komunitetit të donatorëve Përfaqësues i “Miqtë e Parlamentit Rural” Diskutim i hapur me pjesëmarrësit
15:45	Përfundime